



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeho/Prodato Received/Delivery	15 - 12 2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Puneg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIP/SHK	7509/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1392/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga:Arben Mehmeti, kryetar ,Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj -Demi, anëtarë me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1392/2023 të datës 08.11.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] i, me adresë banimi fsh Radivojc, Komuna e Vitisë kundër organit të punësimit/Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1392/2023 e datës 08.11.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Nëpunësve të Shërbimit Publik të Komunës së Vitisë.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] më datë 08.11.2023, kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 6929/2023, e regjistruar me shenjen A.nr.1392/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me harmonizimin e koeficientit duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196, për Zyrtaret Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.11.2023, për mes e-mailit ka dërguar kërkesën për përgjigje

në ankesë të anësueses në Komunën e Vitisë, ndërsa me datë 30.11.2023, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Vitisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 1392/2023 të datës 08.11.2023, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi me numër protokoli 12-112-2147, e datës 30.12.2011; Kërkesë me numër protokoli 02-870/04-0404-900, e datës 06.10.2023; Lista e pagave për periudhën 01.10.2023, deri më datë 31.10.2023; E-maili i datës 24.10.2023; Diplomë me numër protokoli 1067, e datës 15.12.1985; Dëshmi e datës 18.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 30.11.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, lidhur me harmonizimin e koeficientit, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës, ka konstatuar se pozita "*Zyrtare për Përpunimin e Materialin Bibliotekar*", të cilën pozitë e mbanë ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokoli 12-112/2417, të datës 30.12.2011, nuk është pozitë e shërbyesit civil ashtu siç përcaktohet në Ligjin nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik përkatësisht dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe paragrafi 2, në të cilën specifikisht përcaktohet: "*Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimit e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë*", ndërsa ndërlidhur me këtë çështje kolegji i këshillit me që konstaton se ankuesja nuk ka pozitën e nëpunësit të shërbimit civil, atëherë bazuar në Ligjin nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, neni 5, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe paragrafi 3, ku përcaktohet se: "*Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës*", konstaton se ankuesja bazuar në përkrahimin e dispozitave të potencuara si më lartë, meqë nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil, por të nëpunësit të shërbimit publik andaj bazuar nën 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, në bazë të nenin 77, paragrafi 1, të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku

përcaktohet se: "1. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësen/in e shërbimit publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës", sepse marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjit përkatës të Punës, andaj bazuar në nenin 78, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku parashihet: 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës, ndërlidhur me nenin 79 të këtij ligji, ku thuhet se: "Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente".

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1392/2023 të datës 08.11.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës konformë dispozitave të legjislacionit të potencuar si më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda përmes zyrës së personelit të kësaj komune ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Nëpunësve të Shërbimit Publik të Komunës së Vitisë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1392/2023, datë 15/12/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

